Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

**D. DHËNIA E KONTRATËS****23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare

- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

#### **25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

#### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontratës;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

---

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**  
(në rast BOE): \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4.					
	<b>Çmimi total</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

## Shtojca 5.

(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

### **DEKLARATË**

#### **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt ..... është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

---

<sup>6</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

---

## Shtojca 6.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efijencën e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### Shërbimi që kërkohet:

**Afatet e ekzekutimit: 36 muaj**

Sistemi arsimor të Bashkisë Shkodër kërkon te ofrojë shërbimin e sigurisë në objekte për 89 objekte nga të cilat 50 objekte në qytet dhe 39 objekte në Njësi Administrative. Shërbimi i sigurisë së objekteve do të realizohet sipas nevojës së çdo objekti, që do të ofrohet shërbimi pa ndërprerje nga koha e aktivizimit të sinjalit, sipas orareve të përcaktuara nga ora (15:00-07:00). Shërbimi përmes sinjalit të alarmit për marrjen dhe transmetimin e sinjalit të alarmit do të jetë me sinjalizim nga brenda.

Shërbimi me kamera të sigurisë nga jashtë objektit. Objektet do të pajisen me kamera nga jashtë në sasinë sipas nevojës dhe shtrirjes së objektit 178 copë, Kamera nga brenda 178 copë për objekt sipas standartit të kërkuar nga ligji "Për masat shtesë të sigurisë publike". **Të gjitha njësitë e vendosura duhet të kenë linjë të dedikuar të internetit.** Duhet të jenë të vendosuar në kaseta të posacme të mbyllura nga operatori i shoqërisë. Duhet të kenë automat të vecantë për furnizimin me energji elektrike si dhe bateri për vazhdimin e funksionit në rast problemi elektrik.

#### 1. SENSORË ALARMI ME TELA 178 copë

Sensor pyroelektrik me element të dyfishtë

- 15m mbulim volumetrik zbulimi
- Rezistorë EOL (End of Line) të zgjedhshëm
- Teknologjia Blue Wave
- Funksioni i ndjeshmërisë automatike
- Kompensimi i temperaturës digjitale
- Kllapat e provës
- Optika e mbyllur
- Plastika ABS

#### Karakteristikat teknike të sensorit

Rrezja maksimale	15m
Mbulim volumetrik	Yes
Shpejtësia e detektimit	0.3- 3.0m/s
Këndi mbulim	85 degree
Detektimi i zonave numër	60
Detektimi i paketave	7
Mbrojtja e zonës nën sensor	Yes
Filtrat e dritës	6500 Lux
Mbrojtja	Ultraviolet light filter
Lentja	3 dimensional

Opikë	Sealed optics
Lloji i detektimit	Loë noise dual element pyroelectric sensor
<b>Montimi</b>	
Montim në mur	Mbajtësja e përfshirë
Montim tavanor	Mbajtësja e përfshirë
Distanca për gjatësi	1.8 - 2.4m
Monitorimi i certifikuar	2.4m
Kushtet e punës	
Temperatura ambientit	-40C to 80C
Temperatura e certifikuar	-10C to 40C

## **2. DVR 4 KANALE - 89 copë**

Hyrje AUDIO:	1-ch
Kompresimi Video:	H.265+/H.265/H.264+/H.264
Hyrje për kamerat:	4ch, BNC ndërfaqe (1.0Vp-p, 75 Ω) connection
Lloji i suportit të kamerave	Të Suportojë: HDTVInput:3MP,1080P/25Hz,1080P/30Hz,720P/25Hz,720P/30Hz,720P/50Hz,720P/60Hz, Të Suportojë AHD.input:1080P/25Hz,1080P/30Hz,720P/25Hz,720P/30Hz Të Suportojë CVI.input:1080P/25Hz,1080P/30Hz,720P/25Hz,720P/30Hz Të suportojë CVBS input
Ndërfaqe:	BNC (1.0 Vp-p, 75Ω)
Kompresimi audios:	G.711u
Ndërfaqe audio:	RCA (2.0 Vp-p, 1 kΩ)
Transmetim audio:	1-ch, RCA (2.0 Vp-p, 1 KΩ), (using the 1st channel of audio input)
Video/Audio Output	
Dalja CVBS:	1-ch, BNC(1.0Vp-p,75Ω), resolution:PAL:704x576, NTSC:704x480
Dalja HDMI/VGA:	1920 × 1080 / 60 Hz,1280 × 1024 / 60 Hz, 1280 × 720 / 60 Hz, 1024 × 768 / 60 Hz
Regjistrimi:	1080p. Lite.modenotenabled:3MP/1080p/720p/VGA/ĒD1/4CIF/CIF; 1080p Lite mode enabled: 1080p lite/720p lite/VGA/ĒD1/4CIF/CIF

Foto për sekondë:	<p>Main stream:  1080p Lite mode not enabled:  For 3 MP stream access: 3 MP/1080p/720p/VGA/WD1/4CIF/CIF@15fps  For 1080p stream access: 1080p/720p@15fps; VGA/ĒD1/4CIF/CIF@25fps (P)/30fps (N)  For 720p stream access: 720p/VGA/WD1/4CIF/CIF@25fps (P)/30fps (N)  1080p Lite mode enabled:  3 MP@15fps  1080p lite/720p lite/VGA/ĒD1/4CIF/CIF@25fps (P)/30fps (N)  Sub-stream:  WD1/4CIF@12fps; CIF@25fps (P)/30fps (N)</p>
Bitrate i videos:	32 Kbps-6 Mbps
Lloji i transmetimit:	Video/Video&Audio
Audio:	1-ch, RCA (2.0 Vp-p, 1 kΩ) (using the audio input)
Dalja:	1-ch RCA (Linear, 1kΩ)
Bitrate:	64kbps
Transmetim 2 kanale:	Të suportohet
Playback regjistrim:	3 MP/1080p/720p/VGA/WD1/4CIF/CIF
Sinkronizimi:	4-ch
Menaxhimi i rrjetit	
idhjet nga jashtë nr:	128
Protokollet e rrjetit:	TCP/IP, PPPoE, DHCP, Cloud P2P, DNS, DDNS, NTP, SADP, NFS, iSCSI, UPnP?, HTTPS, ONVIF
Hard Disk	
Ndërfaqja:	1 SATA Ndërfaqe
Kapaciteti:	Të ketë të përfshirë 1 copë HDD 1 TB të dedikuar për sistemet CCTV
Ndërfaqje të tjera	

Ndërfaqe rrjeti:	1; 10M / 100M self-adaptive Ethernet ndërfaqe
USB Ndërfaqe:	2 USB 2.0 Ndërfaqes
Serial Ndërfaqe:	1; standard RS-485 serial ndërfaqe, half-duplex
Të përgjithshme	
Ushqimi:	12 VDC
Konsumi:	≤ 7.5W(me out hard disks)
Temperaturat e punës	-10 oC to +55 oC (14 oF to 131 oF)
Lagështia:	10% to 90%

### 3. KAMERA PËR BRENDA - 178 copë

Kamera	
Sensori i imaxhit	2MP CMOS Sensor Imazhi
Lloji i sinjalit	PAL/NTSC
Pikselat eficient	1920(H) × 1080(V)
Min. Illumination:	0.01 Lux @ (F1.2, AGC ON),0 Lux me IR
Shutter Time:	1/25(1/30) s to 1/50,000 s
Lentja:	2.8mm,
Montimi i lentes	M12
Adjustment Range:	Pan: 0 - 360°, Tilt: 0 - 75°, Rotation: 0 - 360°
Ditë dhe natë	IR cut filter me auto switch
Fotot e videos	1080p@25fps/1080p@30fps
Dalja HD	1 Analog HD output
Sinkronizimi:	Internal Synchronization
S/N Ratio:	More than 62 dB

Up the Coax:	Të suportojë
Menu	
Anti-flicker:	On/ Off
Të përgjithshme	
Kushtet e punës	-40 °C - 60 °C (-40 °F - 140 °F) Lagështi 90% ose më pak
Ushqimi	12 VDC±15%
Konsumimi i fuqisë	Max. 4W
Detektim gjatë natës	Deri në 20 m

#### **4. KAMERA PËR JASHTË- 178 copë**

Kamera	
Sensori i imazhit	2MP CMOS Sensor Imazhi
Sinjali i sistemit	PAL/NTSC
Piksela eficente	1920(H)*1080(V)
Min. Illumination:	0.01 Lux @ (F1.2, AGC ON),0 Lux Me IR
Shutter Time:	1/25(1/30) s to 1/50,000 s
Lentja:	2.8mm
Lentja	M12
Këndet e montimit	Pan: 0 - 360°, Tilt: 0 - 180°, Rotation: 0 - 360°
Ditë dhe natë	IR cut filter me auto switch

Foto për sekond në video	1080p@25fps/1080p@30fps
Dalja HD e videos	1 Analog HD output
Sinkronizimi:	Internal Synchronization
S/N Ratio:	More than 62 dB
General	
Kushtet e punës	-40 °C - 60 °C (-40 °F - 140 °F) Humidity 90% or less (non-condensing)
Tensioni	12 VDC±15%
Konsumi i energjisë	Max. 4W
Kushtet e jashtme	IP66
Pamja natën	Deri ne 20 metra

### 5. Instalimi i 89 sisteme të alarmit, 178 Sensorë dhe 89 DVR + 356 kamerave - 1 SET

Instalimi i pajisjeve dhe konfigurimi i sistemit duhet të kryhet për 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Operatori Ekonomik të japi një deklaratë për instalimin e pajisjeve.

Projekti është me celësa në dorë dhe Operatori ekonomik duhet të marri përsipër cdo gjë që do dali gjatë projektit. Pajisjet duhet të jenë të vendosura në kaseta metali në cdo objekt të mbyllur. Brenda tyre duhet të ketë cdo element dhe aksesori plotësues për funksionin e sistemit.

### 6. Kabull Alarmi 7,400 metra.

Konstruksioni i fijeve 6 fije

Konstruksioni i fijeve 7/0.2 mm të lyer me bakër

Instalimi PVC i bardhë

Voltazhi maksimal 50 V rms

Rryma për fije 1 AMP

CSA 0.22 mm

### 7. Kabull LAN/ Rg59 + Ushqim 14,850 metra

Material transmetues:	OFC (Oxygen Free Copper)
(Transmetues) Wire Gauge:	20AWG
Material insulimi:	FPE
(Insulimi)Diametër:	3.66±0.05mm

(Tape)Material:	Shielding Aluminum Foil, 15mmëidth
(Tape)Thickness:	0.04mm
(Braid)Material:	CCA (Copper-clad Aluminum)
(Braid)Braiding Standard:	8*16*0.12mm
(Braid)Braiding Density:	95±1%
(Jacket)Material:	PVC
(Jacket)Average Thickness:	≥0.65mm
(Jacket)Diameter:	6.10±0.2mm
Impedance:	75ohms
Kabulli i ushqimit	
(transmetues)Material:	OFC (Oxygen Free Copper)
(transmetues)Quantity:	2
(transmetues)Diameter:	7*0.385±0.01mm
(Insulimi)Material:	PE (Flame Retardant)
(Insulimi)Diameter:	1.8±0.1mm
(Jacket)Material:	PVC
(Jacket)Average Thickness:	≥0.3mm
Operating Temperature:	-40-80°C
Storage Temperature:	-20-70°C

#### 8. VIDEO STORAGE PËR REGJISTRIMIN E PAMJEVE – 1 COPË

- 64-bit multi-core processor.
- 4 GB high-speed cache.
- Four 1000M ndërfaqe rrjeti.
- 12G SAS high-speed transmission channel.
- Modular and no-cable design and SBB 2.0 structure
- Redundant design for key modules.

#### HDD Detection and Repair/RAID Optimization

- Detection before operation.
- Detection in operation.
- Fault reparation.
- RAID 0, 1, 3, 5, 6, 10, 50, and VRAID.
- Global and local hot spare.
- Quick RAID building.
- Capability of cascading up to tëo storage enclosures

---

## Sistem I avandansuar te dhenash

- Synchronous backup of key information in system disk and HDD.
- RAID-based tamper-proof data technology.
- Auto data synchronization between devices. Energy Efficient
- CPU load balance
- Auto fan tuning
- HDD sleeping User-Friendly UI
- Konfigurim te shpejt.
- Various alarm management.
- SADP protokol suport.
- SNMP protokol suport.

## Surveillance-Specialized Stream Media Direct Storage (Direct Streaming Mode)

- Space pre-allocation strategy.
- Direct storage for video and picture streams.
- Të suportojë direct IP camera/DVR/NVR streaming()
- Të suportojë H264,H264+,H265,H265+.
- Të suportojë N+1.
- Të suportojë camera akses nëpërmjet RTSP, ONVIF, and PSIA protocol.
- Të suportojë alarm/scheduled/manual recording.
- Automatic netëork replenishment (ANR), timely uploading, and video loss alarm.
- Lock key videos.
- VRAID data protection.
- Të suportojë, Direct Streaming Mode dhe IPSAN Mode.
- Search, play and doënload videos by video type or video time

## Kontrollori

Processor:One-controller (64-bit multi-core processor)

Cache: 4 GB ( extendable to 32 GB )

## HDD

HDD Slot:16

Ndërfaqe/Capacitet:SATA/1TB,2TB,3TB,4TB,6TB,8TB,10TB

Hot-sëapping: Ta suportojë

RAID: RAID0,1,3,5,6,10,50.VRAID,JBOD,Hot-spare

## Ndërfaqet

Alarm interface:1

Data ndërfaqe rrjeti:3, 1000M Ethernet interface

Management ndërfaqe rrjeti:1, 1000M Ethernet interface

MiniSAS ndërfaqe:Të Suportohe

COM: 1

USB3.0:2

VAG: None

HDMI: 2

## Rrjeti

Protocol:iSCSI,RTSP,ONVIF,PSIA

## Të përgjithshme

Poëer supply: Gold-metal redundant poëer supply

Konsumi i energjisë ( me HDDS ): ≤308Ë ( 967BTU me 16 HDDs)

Rated: ≤550Ë

Të suportojë temperatura pune:+5°C to +40°C

Storing : -20°C to +70°C

Environment humidity: 20% to 80%RH (non-condensing/frozen)

Storing:5% to 90%RH (non-condensing/frozen)

Shasia: 3U (<48 lartesia)

### 9.HDD 1 TB ENTERPRICE- 89 COPË

- Shkrim i avandësuar i cache-së në shërbim të përmirësimit të algoritmeve improvement in random ërites over last-generation drive
- 8TB, 3.5-inch enterprise drive me 6-disk technology, Gjenerata e 9 e perpendicular recording technology per access to, të dhëna të pastrukturuara në 12Gb/s SAS and SATA 6Gb/s ndërfaqe në industry-standard advanced formats for easy integration into replicated and RAID multi-drive storage servers and systems
- State-of-the-art cache, on-the-fly error-correction algorithms, super parity and end-to-end SAS-based data integrity for accurate data storage
- Rotational vibration tolerance design që ndihmon të ruajë performance konsistente në sisteme multi-drive me densitet të lartë
- Të suportojë 24 orë x7 ditë pune ëorkloads me trafik 550TB në vite-10- fishin e pajisjeve desktop
- Robust performance me dual processors, ramp load technology, top-cover- attached motor and humidity sensor for optimum performance in all chassis
- On-demand PoëerBalance™ feature available for loëer poëer/performance in random read/ërite environments
- Self-Encrypting Drive featuring Instant Secure Erase for cost- saving drive retirement and secure
- Softëare diagnostikues që minimizimin doëntime and maximizon TCO
- Të suportojë Hyperscale applications/cloud data centers me replicated storage
- Massive scale-out data centers and big data analytics
- High-capacity density RAID storage
- Mainstream enterprise external storage arrays (SAN, NAS, DAS)
- Distributed file systems, including Hadoop and Ceph
- Enterprise backup and restore—D2D, virtual tape
- Centralized surveillance
- HDD to be compatible me STORAGE

#### Sasia e mallit që kërkohet:

	<b>PAJISJE SIGURIE</b>	Njësia	Sasia
1	Instalim sisteme alarmi	copë	89
2	Instalim Sensore allarmi me tela	copë	178
3	Instalim Sisteme Vezhgimi DVR 4 + kamera	copë	89
4	Instalim Kamera per brenda	copë	178
5	Instalim Kamera per jashte	copë	178
6	Instalim I sistemeve te alarmit	copë	89
7	Instalim I sistemeve te kamerave	copë	89
8	Kabell alarmi	m	7400
9	Kabell LAN/Rg 59+Ushqim	m	14850
10	Video storage per regjistrimin e pamjeve	copë	1
11	HDD 1TB ENTERPRICE	copë	89
12	Linje Interneti e dedikuar	copë	89
13	Kuti metalike (kasaforte) per ruajtjen e DVR	copë	89
14	Limitator per tensinin e pavarur nga Ambientet e objekteve	copë	89

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE-REFERUAR ANEKSI NR. 1- Bashkëlidhur dokumentave standarte të tenderit**

#### **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Nr	Shpenzime te tjera operative per 1 godine	Shpjegim, reference- ligjislacioni
----	---	------------------------------------

1	<b>Punonjes ne zyren e menaxhimit te sherbimeve (operator)</b>	Ne baze te ligjit nr 7961 datë 12.7.1995 K.P. te ndryshuar, ligjit 75/2014 date 10.07.2014, azhornuar me ligjin 90/2023, VKM nr. 776, datë 19.12.2025 per pagen minimale, eshte llogaritur paga, shtesat e turneve leke ne muaj per 1 objekt.
2	<b>Grup I Gatshem per verifikimin e sinjaleve te alarmit</b>	Ne baze te ligjit nr 7961 datë 12.7.1995 K.P. te ndryshuar, ligjit 75/2014 date 10.07.2014, azhornuar me ligjin 90/2023, VKM nr. 776, datë 19.12.2025 per pagen minimale, eshte llogaritur paga, shtesat e turneve leke ne muaj per 1 objekt.
3	<b>Montues pajisjesh, mirmbajtes</b>	Ne baze te ligjit nr 7961 datë 12.7.1995 K.P. te ndryshuar, ligjit 75/2014 date 10.07.2014, azhornuar me ligjin 90/2023, VKM nr. 776, datë 19.12.2025 per pagen minimale, eshte llogaritur paga, shtesat e turneve leke ne muaj per 1 objekt.
4	<b>Automjete, Matora</b>	Shpenzime për Taksa, mirembajtje, siguracion dhe karburant leke ne muaj

**Rregjistrimi Video duhet të jetë 24/7**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shërbimi që kërkohet:**

1	2	3	5	6	7
Nr	Sherbimi I sigurise ne objekte'	Njësia (Muaj)	Numri total i objekteve	Çmimi Njësi / muaj	Oferta në total (neto)
1.		36	<b>89</b>	<b>(X)</b>	<b>(X)</b>
	<b>Oferta Neto ne total</b>				
	<b>TVSH (%)</b>				
	<b>Oferta total</b>				

Nr	Shkollat Qytet SHKODER
1	Ismail Qemali
2	Salo Halili
3	Azem Hajdari
4	Xheladin Fishta
5	Skenderbej
6	Dëshmorët e Prishtinës
7	Branko Kadia
8	Mati Logoreci
9	Ndoc Mazi

Nr	Shkollat KOMUNA	NJESIA ADMINISTRATIVE
1	Qazim Mehja	Njesia Adm.Ana e Malit
2	Hasan Dardhanjori	
3	Elbacë	
4	Veli Tela	
5	Gjinnazi Oblikë	
6	Frederik Gjon Gjoni	Njesia Adm.Berdice
7	Agim Tafili	
8	Seit Can Tagani	Njesia Adm.Dajc
9	Lucë Agraja 9 vjcare	

10	Martin Camaj	10	Pjetër Gaci	
11	Pashko Vasa	11	Gjergj Laca	
12	Ali Laçe	12	At Gjon Karma	<b>Nj.Adm.Gur i Zi</b>
13	Ndre Mjeda	13	Dëshmorët e Rrencit	
14	Isuf Tabaku	14	Arif Selimi	
15	Liria	15	Zef Jubani	
16	Ruzhdi Daka	16	Gjon Toma Rragam	<b>Nj.Adm.Postrribë</b>
17	Preke Jakova	17	Mes-Myselimi	
18	3 Dhjetori	18	Adem Haxhija	
19	Ernest Koliqi	19	Dragoç	
20	Edith Durham	20	Drisht	
21	28 Nëntori	21	Ura e Shtrejtë	
22	Jordan Misja	22	Prekal	<b>Nj.Adm.Rrethina</b>
23	Oso Kuka	23	Isa Jakupi	
24	Kolë Idromeno	24	Haxhi Hajdari	
25	Shejnaze Juka	25	Tring Smajli	
26	Magazina	26	Hot i Ri Ded Gjo Luli	
27	Qendra Kulturore e femijeve	27	Bardhaj	
		28	Shtoj i Ri-Osman Llampiri	
		29	Ismet Sali Bruçaj	
		30	Shtoj i Vjetër Fiko Cani	
		31	Nikollë Zogorjani	
		32	Gjergj Vat Martini	<b>Nj.Adm.Velipoje</b>
		33	Baks-Rrjoll	

<b>Nr</b>	<b>Kopshte, Çerdhe, Kinema</b>
1	Ngjyrat
2	Xixellonjat
3	Q.Komunitare Multifunkionale
4	Q.K Guri zi
5	Q.K Dajc
6	Q.K Nr 6 /ish konvikti pyjore
7	Q.K Rom
8	Tom Alimhilli
9	Njomzat
10	Cerdhe Perash
11	Cerdhe Manush Alimani
12	Teatri Migjeni
13	Kinema Republika
14	Pallati Sportit
15	Reshit Rusi
16	Streha e qenve
17	Galeria e Arteve
18	Biblioteka
19	Vendi Deshmise dhe Kujteses
20	Muzeo Oso Kuka
21	Muze I Kalase
22	Kuc Kopshti
23	Vilze (Magazine e Arsimit)
24	Isa Jakupi kopshti

25	Bardhaj Kopshti
26	Kopeshti Beb Tusha
27	Shtoj I ri-Osmna Llampiri kopshti
28	Shtoj I vjeter Fiko Cani
29	Kopeshti Ismet Sali Brucaj sorors

## Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

#### **ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT TË SIGURISË PËR VERIFIKIM DHE REAGIM NË OBJEKTET ME SISTEME ALARMI DHE KAMERA**

Për zhvillimin e aktivitetit normal të ruajtjes dhe sigurisë në objekte me sinjal alarmi SHPSF mbështetet në Ligjin Nr. 75/2014, datë 10/07/2014 “Për Shoqëritë Private të Sigurisë Fizike”, udhëzimeve të dala në funksion të ligjit si dhe në Akt-Marrëveshjen dhe Rregulloren e përbashkët të nënshkruar midis SHPSF dhe të autorizuarit për sigurinë e objektit.

Punonjësit e Sigurisë duhet të jenë të trajnuar dhe instruktuar sipas programeve të miratuara me qëllim që të aftësohen për të kryer detyrat e ruajtjes dhe sigurisë sipas standarteve me përkushtim dhe profesionalizëm.

**Për t'ju përgjigjur detyrave për sigurinë e objekteve me kamera dhe sinjal alarmi SHPSF organizohet si më poshtë:**

- 1. Qendra e kontrollit duhet të funksionojë 24/7**
- 2. Grupet e gatshme duhet të funksionojnë 24/7**
- 3. Staf teknik të certifikuar për sisteme alarmi dhe kamera**
- 4. Staf inxhinierike informatik/informaticien**

#### **1. QENDRA E KONTROLLIT**

Qendra e kontrollit kryen detyra për drejtimin, menaxhimin dhe kontrollin e dinamikës së SHPSF- së, për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve, të personave, si dhe veprimtarive social-kulturore sportive fetare e politike.

Qendra e kontrollit është e pajisur me sistem ndërlidhës, radio-komunikim dhe radio alarm, dhe marrje të sinjalit video në çdo njësi administrative. Këto sisteme bëjnë të mundur marrjen në kohë të sinjaleve të alarmit dhe sigurimin e pandërprerë të radio-ndërlidhjes pranë çdo objekti në ruajtje.

Serveri bazë është i pajisur me qendrën multifunksionale ku ka sistemin bazë të marrjes, përpunimit dhe ruajtjes së sinjaleve të alarmit, të marrjes dhe administrimit të të dhënave, në të gjitha rrugët e sigurimit, Radio, GPS-GPRS, GPRS, ADSL dhe ruajtjes së sinjalit video.

- **Organizimi i shërbimit në Qendrën e Kontrollit**

1. Për verifikimin e sinjaleve të alarmit të SHPSF organizon shërbimin me grupe shërbimi të pajisur me armatim, me mjete speciale për ndërhyrje në raste emergjence si dhe automjete, motora për lëvizjen e tyre.
2. Qendra e kontrollit, realizon monitorimin me anë të sistemit të kamerave të cilësisë së lartë, gjurmimin dhe lokalizimi në kohë reale të automjeteve nëpërmjet sistemit GPS/GPRS, si dhe marrja dhe verifikimi i sinjaleve të alarmit (sinjal grabitje, sinjal zjarri) nëpërmjet mënyrave të ndryshme si:
  - a. Nëpërmjet Telefonit Celular (GSM)
  - b. Nëpërmjet Telefonit Fiks (Contact ID)
  - c. Nëpërmjet rrugëve valore (Radio)
3. Qendra e kontrollit është e pajisur me dokumentacionin e nevojshëm ku evidentohet i gjithë aktiviteti i saj të tilla si:
  - a. Rregulloren e funksionimit të shërbimit në Sallën operative.
  - b. Librin e instruktazhit me pjesë (ekstratë) nga aktet normative.
  - c. Evidencën e regjistrimit të Sinjaleve të alarmit.
- ç. Librin e shënimeve.
  - d. Numeratorin telefonik të Drejtuesve të Shoqërisë, të punonjësve të shërbimit sipas objekteve, të titullarëve të subjekteve që Shoqëria ka lidhur kontrata dhe të shërbimeve të urgjencës dhe të Sallave operative të policisë së shtetit.
- dh. Librin e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit.
  - e. Evidenca e regjistrimit të bisedave telefonike me celularë.
- e. Kasafortë metalike për mbajtjen e armatimit dhe pajisjeve speciale.
- f. Shërbimi në qendrën e kontrollit kryhet nga punonjësi i shërbimit (operatori) 24 orë në 24.
  4. Pajisjet e qendrës së kontrollit dhe të dhënat e siguruar nga përdorimi i tyre vihen në dispozicion sa herë që kërkohet nga Policia e Shtetit, organet e prokurorisë, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
  5. Në Qendrën e Kontrollit janë të regjistruara adresat e të gjitha objekteve që ruhen dhe sigurohen me sisteme alarmi.

## **2. GRUPET E GATSHME, ORGANIZIMI DHE PAJISJA E TYRE**

Grupet e gatshme janë elementi më i rëndësishëm i gatishmërisë dhe kontrollit të objekteve të marrë në ruajtje me alarm. Janë personel të trajnuar, certifikuar dhe të pajisur me mjete të lëvizshme të shpejta dhe që manovrohen lehtë (motora dhe makina), veshje dhe pajisje speciale si armatim, pranga, shkop gome, radio, GPS, elektrik dore etj. që mundësojnë reagim të menjëhershëm në situatë të vecanta. Vëmendje me grupet e gatshme i kushtohet provave të gatishmërisë për të testuar shpejtësinë e veprimit dhe kapjen e kohës në situatë kur merret sinjal alarmi.

Aftësimi teknik konsiston në njohjen e mjeteve dhe pajisjeve të vëna në dispozicion si mjetet lëvizëse (makinë, motorë), njohjen e armatimit, mjeteve të komunikimit duke siguruar gatishmëri të përhershme në funksionimin e tyre. Aftësimi taktik konsiston në mënyrën e veprimit me marrjen e sinjaleve të alarmit, rrugët e afrimit për në objekt, bashkëveprimin midis grupeve për kontrollin e objektit, veprimet e grupeve të gatshme kur ka situatë të jashtëzakonshme apo kërcënuese.

## **3. PAJISJET E SISTEMEVE TË ALARMIT.**

Për sigurinë e objekteve me pajisje elektronike kërkohen dy sisteme.

- a. **Me sisteme alarmi** që sinjalizojnë Hapje; mbyllje; alarm zjarri; alarm sulm mbi personelin; alarm bateria e shkarkuar; alarm-dëmtim i sinjalit të alarmit, mungesë energjie elektrike.

---

Sinjalet e alarmit, vijnë në Qendrën e Kontrollit nga Sinjalet e Alarmeve të objekteve nëpërmjet telefonave; me radio dhe internet, për njoftime të ndryshme. Qendra e Kontrollit evidenton në dokumentet përkatëse, të gjithë sinjalet e ardhura dhe zbaton procedurat standarde, sipas specifikës së sinjaleve.

Në rast defektsh të sistemeve të alarmit Qendra e Kontrollit njofton menjëherë Shefin e teknikës; Shefin e shërbimit; personin e shërbimit dhe drejtuesit e SHPSF.

Sistemet e alarmeve që do të vendosen në objekte përbëhen nga:

1. Centrali i alarmit
2. Sensorë lëvizjeje
3. Tastierë Komandimi
4. Pulte
5. Bateria
6. Sirena

Sistemet e alarmeve funksionojnë edhe në kushtet e mungesës së energjisë duke u furnizuar nga një burim ushqimi i pavarur (bateria) e cila e mban pajisjen në punë 8 – 10 orë.

b. **Me sistem kamera.** Sistemi i kamerave shërben për të vëzhguar dhe regjistruar ngjarje që mund të ndodhin në objekt. Për sistemin e vëzhgimit me kamera përdoren pajisje të tilla si:

1. Kamera 4 MP at 25 fps
2. Distanca focale 2.8.mm me color
3. IR (infra të kuqe)
4. Digital Zoom

Ruajtja e materialeve filmike është për një kohë të gjatë.

## **5. FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT TË SIGURISË NË RAST ALARMI**

a. **Përgatitja e grupeve të gatshme para marrjes së detyrës.**

Personeli i Grupit të gatshëm paraqitet për marrjen e detyrës **15 minuta** para. Njihet me problemet që ka pasur gjatë turnit tjetër. Kontrollon pajimet personale, mjetin (motorë ose makinë), mjetet e komunikimit dhe i raporton Qendrës së Kontrollit për gatishmërinë dhe fillimin punës ditore. Merr **udhëzimet**, detyrat nga Qendra e Kontrollit dhe përgjegjësi i shërbimit. Vendoset në venddislokimin sipas planizimit të bërë nga përgjegjësi i shërbimit. Sipas situatës apo informacioneve të marra për problem të sigurisë së objekteve. Grupi i gatshëm kryen detyrën duke qendruar në venddislokimin ose me patrullim.

b. **Veprimet e Qendrës së kontrollit dhe Grupit të gatshëm me marrjen e sinjalit të alarmit**

Operatori në Qendrën e Kontrollit me marrjen e sinjalit nga serveri i qendrës së kontrollit (sallës operative) me radio (telefon) jep urdhër grupit të gatshëm për lëvizje duke i treguar adresën e saktë të objektit, ndjek me GPS lëvizjet e tyre. Për të dhënë një pamje më të qartë të veprimeve të Operatorit, Grupit të gatshëm, Bashkëveprimi midis tyre dhe Grupeve të gatshme të Policisë së Shtetit (112/129), Repartit të Zjarrfikëseve (112/128) apo Urgjencës Mjekësore (112/127) le të improvizojmë dy situata. Elementet e Kodifikimit :

- Operatori në Qendrën e Kontrollit – **“BAZA”**
- Grupi i gatshëm i përbërë nga motoristë të gatshëm dhe mjete të gatshme me kodet: **Skuadra 1, Skuadra 2, Skuadra....., .**
- Kodi i objektit – **x**
- Përgjegjësi i shërbimit **-04**
- Drejtuesi teknik - **02**
- Administratori – **01**

- 
- Patrulla e Policisë – **112/129**
  - Zjarrfikësa - **112/128**
  - Urgjenca mjekësore -**112/127**

### **c. ORGANIZIMI I KOMUNIKIMIT DHE RAPORTIMET**

Komunikimi Qendrës së Kontrollit me Grupet e gatshme realizohet me radio dhe telefon celular.

#### **1. Komunikimi me radio:**

Komunikimi me radio bëhet i koduar, sipas tabelave të organizimit të komunikimit me Grupet e gatshme. Evidentimi i raportimit bëhet në librin përkatës dhe në raportin e operatorit. Qendra e Kontrollit drejton thirrjen me radio sipas udhëzimeve të Presidentit të SHPSF. Për çdo problem në lidhje me R/Komunikimin te Qendra e Kontrollit njofton teknikën dhe ndjek vendosjen në gatishmëri të komunikimit.

#### **2. Komunikimi me telefon:**

Komunikimi me telefon kryhet me telefonat celularë, të miratuar për këtë qëllim nga Presidenti i SHPSF, me të cilët komunikohet me personelin e Gr. e Gatshme.

#### **3. Raportimet**

**Raportimet janë element i rëndësishëm i informacionit dhe komunikimit. Nëpërmjet raportimit mbahen kontakte të vazhdueshme me Drejtuesit e Shoqërisë.**

**Operatori në fund të cdo muaji duhet të paraqesë raport për ofrimin e shërbimit në formë shkresore dhe elektronike në DVD me përmbajtje (export alarmi të cdo objekti dhe screenshot të sistemit nga video për cdo objekt). Në raste të vecanta me kërkesë të Autoritetit kontraktor, kompania duhet të paraqesë raport sipas kërkesës të bërë (shkresore dhe DVD pamje). Gjithashtu raportin e të gjitha objekteve online në cdo ditë nga monitorimi me kamera.**

**Në rast aktivizimi të alarmit duhet të paraqesë**

- **Datën dhe orën e alarmit**
- **Nisjen e grupit të gatshëm për verifikim**
- **Mbërritjen e grupit të gatshëm**
- **Problematikën shoqëruar me proces-verbal**

---

## Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të

---

fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

---

## 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

*Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.*

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera se fondit limit.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**2.2.2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2023-2024-2025 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivi.

**2.2.3** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2025**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

